

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.N. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ankesën e të dëmtuarit F.R. dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit Sh.N., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë PKR.nr.632/2016 datë 27.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 03.03.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.632/2016 datë 27.12.2016, **vërtetohet.**

Hudhet si e pa lejuar ankesa e të dëmtuarit F.R..

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.632/2016 datë 27.12.2016, e ka shpallur fajtor të akuzuarin Sh.N., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 i KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale dhe me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale. Është detyruar i akuzuari të i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I dëmtuari F.R. për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil. Të akuzuarit i është konfiskuar revolja e tipit “Petro Bereta” e kalibrit 7.65 mm, me numër serik EJC1590109 dhe 5 (pesë) fishek të kalibrit të vogël si mjet i kryerjes së veprës penale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

-Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal dhe ka propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tersi këtë ankesë ndërsa aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që të akuzuarit të i shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje më të gjatë.

-I dëmtuari F.R., për shkak të vendimit mbi dënimin dhe shpenzimet e procedurës penale, me propozim që aktgjykimi i shkallës së parë të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ose ta bëj ndryshimin e aktgjykimit sa i përket kualifikimit juridik ngase në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë tiparet e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe të veprës penale të mbajtjes në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 të KPRK, të akuzuarit të i shqiptoj një dënim më të rëndë.

- Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.N. av. B.T., ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që ankesa e Prokurorisë të refuzohet si e pa bazuar.

Prokuroria e Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.84/17 të datës 21.02.2017 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë të aprovohet, ndërsa ajo e të dëmtuarit F.R. të hudhët e pa lejuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa e Prokurorisë nuk është e bazuar ndërsa ajo e të dëmtuarit është e pa lejuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë nuk janë të bazuara. Në ankesën Prokurorisë, nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që kishte me ndikuar në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit, por thekson se edhe pse qëndrojnë rrethanat lehtësuese të cilat i ka theksuar gjykata e shkallës së parë asnjëra prej tyre nuk është e tillë që ta arsyetoj një dënim shumë të butë. Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që i ka konstatuar dhe vlerësuar drejtë gjykata e shkallës së parë, si pranimin e fajësisë sjellja dhe qëndrimi korrekt i tij, pendimin e shprehur nga ana e të akuzuarit, premtimin se nuk do të përsëris në të ardhmen këto veprime, gjendja e tij ekonomike, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Kjo gjykatë ankesën e të dëmtuarit e hudhi si të pa lejuar për faktin se sipas dispozitës së nenit 381 par. 3 të KPP, i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë

ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionin penal për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale, e që në rastin konkret vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari nuk hyn në veprat penale që lejohet ankesa e të dëmtuarit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 400 dhe 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.74/2017, më 03.03.2017

Procesmbajtësi,

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja

Eroll Gashi

1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Abdullah Ahmeti _____